REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PRRENJAS

Dt,17.01.2022

NJOFTIM

Për përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjën rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Prrenjas

Bazuar në ligjin nr. 8308, dt. 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; udhëzimin nr. 5627, dt. 18.11.2016 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, neni 11; urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Prrenjas nr.295 , dt. 07.12.2021, “Për përzgjedhjen e subjektit/subjekteve që do të licencohen në linjat e rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve të Bashkisë Prrenjas ”:

Bashkia Prrenjas njofton zhvillimin e konkursit për përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjën rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve si më poshtë:

1	**Qukës - Prrenjas**

Subjekti fizik ose juridik duhet të disponojë automjete të përshtatshme për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe duhet të dorëzojë pranë Bashkisë Prrenjas dokumentacionin për pjesëmarrjen në konkurs në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 5627, dt. 18.11.2016, të ndryshuar, si më poshtë:

1. Kërkesa.
2. Formulari i autodeklarimit (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
3. Vërtetimi nga Gjykata (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
4. Vërtetimi nga Prokuroria (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
5. Dokumentacioni i kredibilitetit bankar.
6. Çertifikata e kompetencës profesionale në transportin rrugor (në rast se subjekti disponon më shumë së një mjet).

7. Çertifikata e regjistrimit dhe ekstrakti i regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit nga Q.K.B.

8. Leja e qarkullimit (për çdo autobus).

9. Çertifikata e kontrollit teknik (për çdo autobus).

10. Akt-vlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve (për çdo autobus).

11. Çertifikata e kalibrimit të tahografit (për çdo autobus).

12. Kontrata për sigurimin e automjetit (për çdo autobus).

13. Kontrata për sigurimin e pasagjerëve (për çdo autobus).

14. Leja e drejtimit.

15. Çertifikata e Aftësimit Profesional.

16. Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij).

17. Kontrata me agjensinë për transport udhëtarësh brenda vendit.

18. Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Liçencave , mbi kryerjen e pagesës të taksave dhe tarifave vendore (për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në periudhën e mëparshme).

Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje e noterizuar.

Dokumentacioni të dorëzohet pranë Bashkisë Prrenjas, deri në datën 27.01.2022 .

Kriteret për klasifikimin e subjekteve, në rast se ka më shumë se një aplikant për linjën përkatëse, do të jenë sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë Prrenjas VKB nr.74, dt.09.10.2019. Klasifikimi bazohet në :

1. Vitin e prodhimit të automjetit.

2. Numrin e automjeteve që do të përdoren për linjën.

3. Numrin e viteve që subjekti mund të ketë ushtruar veprimtarinë në transportin e udhëtarëve me autobusë.

Për informacion më të detajuar subjektet e interesuara mund të drejtohen pranë Bashkisë Prrenjas